

## **Klaudio Çollaku**

Z.Klaudio Çollaku ka lindur më 27.02.1984 në Tiranë. Është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës në vitin 2009 (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit) me titullin Inxhinier Gjeodet.

Eksperiencën në administratën publike, Z. Çollaku e ka nisur si specialist pranë Sektorit të Hartografisë, në Drejtorinë Qendrore të "ALUIZNI-t, gjatë viteve 2006-2013. Më pas nga viti 2013 -2014 ka mbajtur pozicionin e Përgjegjësit në Sektorin e Gjeomatikës në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Prej vitit 2011, Z. Çollaku është pedagog i ftuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, katedra e Gjeodizisë në fushën e Fotogrametrisë. Që nga viti 2014 mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit pranë Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor. Gjithashtu Z. Çollaku ka një eksperiencë të gjerë, nga viti 2003 deri në vitin 2014, në fushën e Hartografisë dhe GIS-it si ekspert në projekte dhe programe të ndryshme.

Z. Klaudio Çollaku zotëron shumë mirë gjuhët Angleze dhe Italiane.